

Gjurma bullgare në mbishkrimet murale të manastirit Hora në Stamboll



Shtëpia e fundit e Asenëve - e kërcënuar të ndjekë fatin e “Shën Sofjes”

Manastiri Hora* në Stamboll, i njohur me mbishkrimet e veta të papërsëritshme murale, mbase do të ndjekë fatin e kishës emblematike të Kostandinopojës “Shën Sofja”. Lajmi për kthimin e tij në xhami, përmes dekretit të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan nga data 21 gusht tronditi përsëri opinionin kulturor botëror.

Një hap i ngjashëm është sa një humbje për botën e krishterë, por po kaq dhe një goditje mbi trashëgiminë kulturore botërore”, komenton në një intervistë për agjencinë BGNES profesori Emanuell Mutafov nga Akademia Bullgare e Shkencave.

Në mesin e muajit gusht, në lidhje me festën e madhe të krishterë Fjetja e Hyjlindëses Mari, doli nga shtypi studimi shkencor i profesorit, kushtuar dhe dedikuar adhurimit dhe nderimit ndaj Nënës së Zotit në artin kishtar të Kostandinopojës.

“Libri im për shkak të rrethanave të krijuara, është punimi i fundit shkencor i shkruar për këtë kishë, kur ajo që akoma një muze-shënon profesori Mutafov dhe shton: Fare nuk jam i lumtur nga ky fakt. Siç thotë Patriarku Ekumenik Bartolomeu I, vendimi për kthimin e kishës në xhami shkakton dhe një dhimbje fizike tek të krishterët. Tek unë gjërat dublohen, sepse unë jam një nga studiuesit, pavarësisht dhe tepër modest i kësaj kishë.”

Në monografinë e tij autori mbron hipotezën se, **në paraklisin e kishës Hora, janë varrosur pasardhësit e Paleologëve** (të cilët kanë drejtuar Bizantin që nga viti 1261 deri në vitin 1453) dhe **Asenët** (të cilët kanë drejtuar Mbretërinë e Dytë Bullgare në periudhën e viteve 1187 dhe 1280).

“Duke ndjekur të gjithë historinë dhe kryesisht burimet e lidhura me manastirin Hora si tekste dhe epitafe, arrita deri tek konkluzioni se në arkosoli është e varrosur mbretëresha Irina Paleologina. Ajo është një princeshë bizantine – motra e perandorit Andronik II Paleolog dhe bashkëshorte e mbretit bullgar Ivan Asen III. Në dy arkosolitë e tjera janë varrosur dy djemtë e saj. Një fakt i padiskutueshëm është se, në imazhet e manastirit Hora ekzistojnë monogramet e Asenëve.”

Ivan Asen III dhe Irina Paleologina i japin zanafillën njërit prej klaneve më të fuqishëm bizantin, i cili luan një rol mjaft të rëndësishëm jo vetëm në Ballkan , por dhe në Evropën Perëndimore dhe në Rusi. Që këtu dalin sundimtarët e fundit të Perandorisë Bizantine, si dhe mbreti Ivan Grozni. Mbreti i parë rus është nipi i Sofija Asenina Peleolog, mbesë e perandorit të fundit bizantin dhe stërmbesë e Ivan Asenit III, një nga figurat e shquara të Perandorisë Ruse.

Por, tani ama e gjithë kjo histori do të fshihet duke u kthyer në një simbol shpirtëror islamik, kanë frikë historianët. Kurse **me këtë akt ndalohet dhe prania deri tek njëri prej monumenteve më të rëndësishme të artit Bizant të Paleologëve që është me një rëndësi botërore.**

“Dhe me qenë se këto veprime janë politike, ato duhet të shkaktojnë dhe kërkimin e përgjigjes politike. Ajo duhet të jetë e shpejtë dhe kategorike, jo vetëm në nivel shtetesh, por dhe në nivel të Bashkimit Evropian -

apelon profesori Mutafov. **Sa i përket kthimit të “Shën Sofijes” nga muze në xhami, reagimi qe shumë i butë dhe tepër i pasigurt. Tani ne shkëpusim një kapitull të tërë nga libri mbi artin bizantin për breza të shumtë përpara, sepse Hora është një xhevahir i vërtetë. Asnjë nuk e mohon periudhën, në të cilën këto monumente kanë funksionuar si xhami. Ajo është mjaft e gjatë dhe asnjë nga njerëzit inteligjentë nuk do as “Shën Sofjen” as Hora të jenë me statusin e kishave. Ne duam që ato të mbeten hapësira neutrale ose muze”.**

Profesori Mutafov është kategorik se, kjo e cila po ndodh gjatë viteve të fundit në Turqi është fshirje e shtetit laik dhe kthimin e tij në lider të islamit. Kurse gjatë realizimit të këtij plani mbase akoma kisha të tjera bizantine do të kenë po këtë fat.

****Manastiri Hora është një nga monumentet bizantine më të konsiderueshme të studiuara në shkencën tonë moderne. Me arkitekturën e vet, me mozaikët e shkëlqyer dhe me mbishkrimet murale ai është një shembull i papërsëritshëm të artit bizant nga epoka e Paleologëve, i denjë për thesarin e trashëgimisë kulturore botërore. Gjatë vitit 1453 kisha e krishterë është e para të cilën osmanlinjtë e fyejnë gjatë ardhjes në Kostandinopojë dhe që të mund të rrëmbejnë kornizën e argjendtë e bëjnë copë-copë ikonën çudibërëse të Shën Mërisë, mbrojtëse e kryeqytetit të Bizantit. Më vonë aty rreth vitit 1511 kisha është kthyer në xhami /Karie xhami/, kurse që nga viti 1945 e këtej është muze. Akoma nuk është saktësuar se kurrë, pas dekretit të presidentit nga data 21 gusht 2020, ajo do të kthehet në një shtëpi lutëse islamike.***

Fotos: BGNES

Përgatiti në shqip: Nataniela Vasileva